

NIKO LAÇO

(1908 - 1986)

ÇULLAJ A.

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Natyrore, Departamenti i Kimisë.

Pesëdhjetëvjetori i themelimit të Universitetit të Tiranës, e në këtë kuadër edhe i degës së Kimisë Industriale, na jep rastin që të kujtojmë ata që vendosën bazat e mësimdhënies e të kërkimit shkencor në fushën e kimisë, si dhe të vemi në pah kontributin e veçantë të tyre. Ndër ta është padyshim edhe Niko Laço.

Niko Laço lindi në Dardhë të Korçës në vitin 1908. Studimet fillore i kreu në fshatin e lindjes dhe më pas vazhdoi Liceun e Korçës, bashkë me shumë shkencëtarë të ardhshëm si profesorët e nderuar Sotir Kuneshka, Islam Rusi etj. Ai u shqua për inteligjencën dhe pasionin duke i përfunduar studimet me rezultate të shkëlqyera. Kërkoi që t'i jepej bursë për të vazhduar studimet e larta dhe meqenëse kjo kërkesë nuk u miratua, familja vendosi që ai të kryente studimet e larta në Athinë me të ardhurat që i ati i Nikos, emigrant në SHBA, i dërgonte familjes.



Në vitin 1938 përfundoi studimet për Kimi, në Universitetin e Athinës, dhe kthehet në atdhe. Filloi punën si mësues i lëndëve të shkencave të natyrës në Normalen e Elbasanit. Aty krijoi një miqësi të ngushtë me shkrimtarin e njohur Nonda Bulka, të cilin e kujtonte shpesh për humorin dhe sarkazmën e tij ndaj pseudointelektualëve profashistë të asaj kohe. Më vonë e transferuan në gjimnazin e Shkodrës, ku qëndroi vetëm pak kohë për tu rikthyer në Normalen e Elbasanit. Në vitin 1942, gjatë periudhës së luftës Italo-Greke, pushohet nga puna për shkak se ishte i martuar me një vajzë greke. Qëndroi në fshatin e lindjes deri në çlirimin e vendit.

Pas çlirimit, jeta e Nikos do të merrte një goditje të rëndë, sepse akuzohet si filogrek nga organet e sigurimit të Koçi Xoxes. Ndonëse nuk u gjet ndonjë provë për këtë akuzë, ai do të dënohet dhe do të vuajë tre vjet burg në Berat. Burgu do të linte një 'njollë' në vlerësimin zyrtar të tij nga sistemi komunist duke lënë në hije aftësitë profesionale dhe kontributin e tij.

Pas lirim nga burgu, profesor Nikoja punon si specialist kimist në Ministrinë e Industrisë dhe në Institutin e Kërkimeve Industriale. Gjatë kësaj periudhe ai krijoi një bashkëpunim dhe miqësi shumë të ngushtë me drejtorin e Institutit Prof. Islam Rusin. Për 20 vjet, nga viti 1962 deri në vitin 1982, Prof. Nikoja ka qenë punonjës i Katedrës së Kimisë Analitike të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, ku edhe del në pension në moshën 74 vjeçare. Megjithë moshën e thyer, pasioni i jashtëzakonshëm për punën në laborator bën që ai të vazhdojë të punojë në katedër me orar të plotë (kundrejt një shpërblimi fare të vogël) deri sa iu shfaqën simptomat e para të një sëmundje të rëndë, e cila i mori jetën më 26 korrik 1986.

Aktiviteti shkencor dhe mësimor i Niko Laços është i gjerë dhe i shumanshëm. Kontributi më i madh i tij është padyshim në fushën e kimisë analitike, duke qenë jo vetëm lektor i parë i kimisë analitike sasiore, por edhe themelues i sektorëve të kërkimeve analitike në FShN. dhe në Institutin e Kërkimeve Industriale. Ai ka qenë autor i vënies në jetë për herë të parë i qindra metodikave analitike dhe jo vetëm kaq, por ai ishte kritik dhe krijues ndaj tyre dhe i modifikonte e përmirësonte ato. Kur punoje me Prof. Nikon e ndjeje që nuk kishte analizë kimike të përzemësueshme, sepse ai njihte me imtësi çdo hallkë të metodikës, përdorte në mënyrë të përsosur teknikën laboratorike dhe kishte një përvojë veti të paarrtshme në këtë drejtim. Nga duart e profesor Nikos kanë dalë shumë analiza kimike të mineraleve dhe lëndëve të tjera të para që vendi ynë eksportonte dhe në të gjitha rastet e reklamimeve rezultatet e tyre nuk janë kontestuar nga laboratorët e huaja të arbitrazhit.

Aktiviteti i profesor Nikos nuk kufizohej vetëm në fushën e analizave kimike. Ai me njohuritë e pasura thuajse në të gjitha drejtimet e kimisë ka kryer shumë studime me vlerë, ndër të cilat mund të përmendim studimet për kromitet, boksidet, argjilat, tokat, oligoelementët në toka, kurse gjatë viteve të fundit atë të prodhimit të ferriteve të buta (një material i patentuar që përdoret në pajisjet e telekomunikimit). Si shkencëtar, ai nuk u shkëput asnjëherë nga laboratorin, nga pjesëmarrja e drejtpërdrejtë në eksperiment dhe nga konsultimi me literaturën. Ai zotëronte disa gjuhë të huaja si frëngjisht, anglisht, italisht, gjermanisht dhe greqisht.

Profesor Nikoja ka qenë për një kohë të gjatë titullar i lëndës kryesore të kimisë analitike dhe autor i përshtatjes me origjinalitet i një teksti bazë teorik dhe praktik. Një kontribut të rëndësishëm ai ka dhënë në edukimin e shumë studentëve dhe kualifikimin e mjaft kuadrove kimistë. Ai ka udhëhequr me dhjetëra tema diplomash si dhe kualifikimin e një pjese të punonjësve të Katedrës. Pasioni për punën në laborator dhe njohuritë e thella të tij kanë gjeneruar inspirim shkencor për shumë kuadro të ardhshme. Por duhet thënë se të punoje me Prof. Nikon nuk ka qenë e lehtë, pasi ai ishte shumë ekzigjent dhe kritik i rreptë. Veç kërkesës për një disiplinë shkencore ai nuk pranonte të bëhej pjesë e punimeve të dobëta apo rezultateve të dyshimta. Kushdo që ka punuar me Prof. Nikon e kujton atë për modestinë, bujarinë dhe sinqeritetin për tu transmetuar përvojën dhe njohuritë e veta kolegëve dhe brezave të rinj. Laboratorët ku ai ka punuar kanë qenë ‘faltore’ e tërë kimistëve të vendit ku specialistë të kimisë, por edhe të fushave të tjera vinin për tu konsultuar dhe zgjidhur problemet.

Profesor Nikoja kishte një personalitet të fortë. Ai ishte shumë i thjeshtë, i dashur, por edhe nuk nguronte të thoshte hapur mendimet e veta, nganjëherë edhe të kundërta me ato zyrtare të kohës. Ai ishte shumë i pasionuar pas natyrës dhe çdo vit shkonte në fshatin e tij të lindjes për të cilin ruante mall dhe dashuri të veçantë. Ai ishte një bashkëshort, baba i një djali dhe gjysh i mrekullueshëm për nipin dhe mbesën.

Profesor Niko Laço meriton një nderim të veçantë për kontributin e tij të çmuar në arritjet e degës së kimisë industriale dhe të shkencës së kimisë analitike në vendin tonë. Ai mund të quhet pionieri dhe themeluesi i shkencës së kimisë analitike shqiptare.

Për të karakterizuar Nikon si shkencëtar është shumë e përshtatshme një nga kërkesat e Statutit të Akademisë së Amadanit: ‘Akademikët mendojnë shumë, shkruajnë pak dhe flasin sa më pak që të jetë e mundur’. I tillë ishte profesor Niko Laço dhe të tillë do e kujtojnë të gjithë ata që e kanë njohur.